



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. 523

Tiranë 19/6/2025

VENDIM

Nr. 19, datë 19.6.2025

PËR
NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVIT AFATGJATË MATERIAL
“SERVER ROUTER PËR TELEPREZENCE”,
NËPËRMJET PROCEDURËS SË ASGJËSIMIT

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “f”, të nenit 53, pika 6, shkronja “b” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 3, të nenit 22, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3 shkronja “a”, dhe të nenit 23, pika 1, shkronjat “b” dhe “ç” të Rregullores nr. 5, datë 30.03.2017 “Për administrimin e aktiveve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 Rregullores nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivit afatgjatë material “Server router për teleprezencë”, me kod unik indentifikimi të aktivit 734883, nëpërmjet procedurës së asgjësimit”.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për mbikëqyrjen e punës të njësive organizative të Agjencisë, për zbatimin e këtij vendimi, dhe informimin e Këshillit Drejtues mbi zbatimin e tij.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

